



## **Njoftim për shtyp 18 Qershor 2020**

18 June, 2020 by **KLGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot me datë 18.06.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën shqyrtoi disa çështje të rëndësishme.

Në funksion të plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli miratoi vendimet për plotësimin e katër kriterëve për ngritjen në detyrë në këto gjykata nga kandidatët z. Erjon Çela, znj. Miliana Muça, znj. Daniela Shirka dhe znj. Iliriana Olldashi si dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit të tyre.

Gjithashtu në vijim të rendit të ditës, në kuadër të ecurisë për ringritjen dhe funksionalitetin e plotë të Gjykatës së Lartë, Këshilli miratoi vendimet për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë për kandidatët magjistratë përkatësisht z. Klodian Kurushi, z. Sokol Ibi, znj. Albana Boksi, znj. Alma Hicka, **znj. Klodiana Veizi**, znj. Manjola Xhaxho, z. Gent Medja dhe z. Sokol Ngresi.

Në përfundim, Këshilli pas shqyrtimit të kërkesave të disa gjykatave të vendit vendosi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

***Informacioni i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KLGJ-së në rubrikën e njoftimeve në linkun:***

***<https://klgj.al/2020/06/njoftim-per-shtyp-18-qershor-2020/>***